

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

ASC – 10 – 0033

Në padinë e

1. [REDAKTUAR], person fizik

Fshati Milloshevë, Obiliq

2. [REDAKTUAR], person fizik

Fshati Milloshevë, Obiliq

3. [REDAKTUAR]

Fshati Bakshi, Obiliq

4. [REDAKTUAR] dhe të tjerët

Fshati Milloshevë, Obiliq

Paditësit

Kundër

Kombinati Bujqësor Industrial "[REDAKTUAR]"

Fushë Kosovë

I Padituri

[REDAKTUAR]

Fshati Bakshi, Obiliq

Ankuesi

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, në lidhje me ankesën e Paditësit/Ankuesit kundër

aktvendimit të DHPGJS-së së datës 11 shkurt 2010, SCC-09-0080, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 gusht 2010 lëshon këtë:

AKTVENDIM

- 1. Ankesa refuzohet si e pabazuar. Miratohet Aktvendimi i Trupit Gjykses i Dhomës së Posaçme në lëndën SCC-09-0080 i datës 11 shkurt.**
- 2. Në rastin e ankesës, eliminohet pika 2 e aktvendimit të DHPGJS-së të datës 11 shkurt 2010.**
- 3. Ankuesi obligohet të paguajë tarifën gjyqësore në shumë prej 60 eurove për procedurën ankimore pranë Dhomës së Posaçme.**

Rrethanat Procedurale dhe faktike

Më 18 maj 2009 Ankuesi së bashku me Paditësit e tjerë ushtruan një padi pranë DHPGJS-së duke kërkuar që të bëhet verifikimi i të drejtave të tyre pronësore si dhe kthimi i tokës bujqësore e cila është regjistruar në emër të të Paditurit.

Më 8 qershor 2010 Trupi Gjykses lëshoi një urdhër për sqarim duke kërkuar nga Paditësit që të sqarojnë:

- nëse padia është ushtruar nga katër paditësit e emëruar apo nga tërë fshatarët;
- në rast se padia është ushtruar në emër të gjithë fshatarëve, të dorëzohet emri dhe adresa e secilit Paditës si dhe autorizimi i nënshkruar nga secili Paditës;
- "çështjen lëndore dhe të gjitha faktet materiale që lidhen me padinë, kryesisht por jo vetëm me:
 - Ngastrat kadastrale që janë kërkuar nga secili paditës
 - Detajet precize të mënyrës në të cilën prona e patundshme ka ardhur nën posedim/pronësi të paditësve

III

- Detajet precize të evidencës që paditësit dëshirojnë të dëshmojnë gjatë seancës dëgjimore të lëndës për të dëshmuar pretendimet e tyre

- (...)

Më 11 shkurt 2010 Trupi Gjykses refuzoi padinë si të papranueshme në pajtim me Nenin 28.4 të UA të UNMIK-ut 2008/6, pasi që nuk ishin plotësuar kushtet e Nenit 25 dhe 27 të së njëjtës UA.

Në veçanti Trupi Gjykses ka pohuar se Paditësit nuk kanë parashtruar një sqarim në urdhrin e datës 8 qershor 2009, duke kërkuar, në mesin e pikave tjera, një sqarim në lidhje me atë nëse padia është parashtruar vetëm nga të katër Paditësit apo nga tërë fshatarët, ashtu siç është kërkuar me anë të Nenit 27.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6 si dhe duke përmendur lëndën si dhe të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me padinë, në veçanti por jo vetëm në lidhje me ngastrat kadastrale, ashtu siç është kërkuar me anë të Nenit 27.2 (e) të UA të UNMIK-ut 2008/6.

Aktvendimi i është dorëzuar Ankuesit më 1 mars 2010.

Më 10 mars 2010, ██████████ ushtroi një ankesë kundër aktvendimit të sipër përmendur, duke përcaktuar se ai nuk dëshiron që të jetë pjesë e veprimit kolektiv më tutje.

Ankuesi pohon se padia ka të bëjë në lidhje me 6 hektarët e tokës, të cilat kanë qenë pronat e babait të tij të vdekur, i cili atë tokë e kishte trashëguar nga babai i tij. Ankuesi konteston aktvendimin e Trupit Gjykses si të paplotësuar dhe të bazuar në vlerësime të gabuara të gjendjes faktike. Ai pohon se familja e tij dhe ai vetë kanë përdorur tokën në fjalë që nga viti 1998, një tokë e cila është e vendosur përballë pompës së benzinës "██████████". Megjithatë i tërë dokumentacioni në lidhje me të ka humbur gjatë konfliktit, prandaj Ankuesi kërkon të dëgjohen dëshmitarët "të cilët do të verifikojnë padinë".

Arsyetimi Ligjor

Ankesa është e pranueshme, por e pabazuar. Bazuar në nenin 63.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6 Kolegji i Ankesave ka vendosur që të vazhdojë me pjesën verbale të procedurës.

Edhe pse ankesa është e pabazuar (krahaso arsyet e dhëna më poshtë), Kolegji i Ankesave në këtë rast dëshiron të vë pah se pjesët e arsyetimit që janë dhënë për hedhjen padisë poshtë nga ana e Trupit Gjykses nuk qëndrojnë në rishikimin ligjor:

Opinionin e Trupit Gjykses nuk mund të ndiqet tani, pasi që ka refuzuar padinë si të papranueshme për shkak të mungesës së sqarimit në lidhje me pyetje se në emër të kujt është parashtruar padia. Ankuesi ka vepruar sipas urdhrit të Trupit Gjykses në lidhje me pjesën ku kërkohet sqarimi në lidhje me numrin e paditësve, pasi që shkresa përmban, bashkë me padinë e nënshkruar nga 4 (katër) përfaqësuesit e Paditësve, emrat dhe nënshkrimet e fshatarëve të fshatit Milloshevë, komuna e Obiliqit. Është e dukshme, se ata janë Paditësit. Pasi që të gjithë ata kanë nënshkruar, nuk ka pasur nevojë për një autorizim.

Përderisa Trupi Gjykses e ka refuzuar padinë si të papranueshme për shkak të mungesës së fakteve dhe argumenteve ligjore, duke përfshirë "të gjitha faktet materiale në lidhje me padinë në veçanti por jo vetëm në lidhje me ngastrat kadastrale, ashtu siç është kërkuar me anë të Nenit 27..2 (e) të UA të UNMIK-ut 2008/6, atëherë ky argumentim ligjor nuk mund të ndiqet (shih ASC-09-0072):

Neni 28.2 (f) në kriterin e pranueshmërisë për në padi përmend në mes tjerash "... kushtet e Neneve 25 dhe 27 ...", në shikim të parë duke dhënë përshtypjen që të gjitha elementet e përmendura aty mund të çojnë në hedhjen poshtë të padisë si të papranueshme, nëse nuk veprohet sipas urdhrit (shih Neni 28.4 UA 2008/6). Një reflektim më i ngushtë, megjithatë, zbulon se sfera e kësaj dispozite duhet të reduktohet mbi bazat teleologjike:

Me sa duket, një ndër parimet e zakonshme të Kodeve të Procedurës Civile të kontinentit të Evropës është përfundimi i një padie (për pyetjen nëse faktet e pretenduara, në lidhje me argumentet ligjore të prezantuara mund të kenë

pasojë ligjore ashtu siç është kërkuar në padi) nuk është çështja e pranueshmërisë së padisë, por e meritave të saj. Nëse faktet (e mjaftueshme) dhe /apo argumentet ligjore nuk prezantohen, apo nëse faktet e pretenduara nuk çojnë drejt konkluzionit të nxjerrë nga Paditësi, padia duhet që të refuzohet si e pabazë, nëse nuk sqarohet sipas kërkesës.

E njëjta vlen, përderisa është përfshirë në urdhrin për sqarim të Trupit Gjykses, edhe pse nuk është reflektuar në mënyrë eksplicite në aktvendimin e atakuar, për kërkesën për të siguruar “detaje të hollësishme të evidencës që paditësit dëshirojnë të ofrojnë gjatë seancës dëgjimore të lëndës për të vërtetuar deklaratat e tyre”: Në parim, vetëm faktet e kontestuar kanë nevojë që të vërtetohen nga Paditësi. Nëse i Padituri nuk konteston faktet e precizuara në padi, nuk ka nevojë që të merret dëshmia. Një listë dëshmish mund të jetë e dobishme vetëm nëse mbledhja e dëshmimeve është e nevojshme. Një padi mund të refuzohet si e pabazë nëse Paditësi nuk arrin të dorëzojë dëshmi për të provuar faktet që i Padituri i ka kontestuar. Para përfshirjes së të Paditurit, lista e dëshmimeve mund të kërkohej, nëse Paditësi duhet të sqarojë çështje të tjera, por nuk mund të jetë çështje në atë fazë të procedurës. Për më tepër, mungesa e dëshmisë e cila mund të jetë e nevojshme për meritat asnjëherë nuk mund të çojë drejt hedhjes poshtë të padisë si të papranueshme.

Për lëndën në fjalë, i Padituri nuk është përfshirë akoma. Faktet materiale, lista e dëshmimeve, dhe argumentet ligjore nuk janë çështje relevante.

Prandaj, Ankuesi nuk ka arritur që të sqarojë lëndën. Ai nuk ka ofruar asnjë indikacion për ngastrat kadastrale në fjalë, as nuk ka ofruar numrat e ngastrave kadastrale. Ky lloj informacioni, siç edhe shihet në mënyrë korrekte nga Trupi Gjykses, është i rëndësishëm më të lartë për pranueshmërinë e padisë, pasi që duhet të jetë shumë e qartë, se çfarë duhet që saktësisht të mbulohet si res iudicata në rast se merret një aktvendim mbi meritat.

Duke përmbledhur atë që u tha më sipër, bazuar në Nenin 65 lit. a e UA 2008/6 e UNMIK-ut, Kolegji i Ankesave e konsideron ankesën si të pabazuar dhe e refuzon atë, dhe në të njëjtën kohë e mbështet aktvendimin e Trupit Gjykses. Pasi që gjykata nuk ka vendosur mbi meritat e lëndës, refuzimi nuk krijon *res iudicata*; rrjedhimisht, Paditësi/Ankuesi mund të ushtrojë përsëri një padi të

duhur, duke përcaktuar saktësisht se cilat janë parcelat që ai dëshiron të jenë lëndë e padisë, pranë DHPGJS-së.

Më vonë, në rast ankese pika 4 e aktvendimit të ankimuar duhet të fshihet, pasi që instruksionet për të ushtruar një ankesë duke cituar ligjin janë, pa asnjë zgjedhje nga ana e gjykatës, që të mos merret asnjë vendim në dispozitiv. Një informacion i tillë mund të jepet brenda arsytimit ligjor apo të bashkëngjitet vetëm në një aktvendim, por nuk mund të jetë pjesë e tij (Shih ASC-09-0108 et al.).

Shpenzimet / Tarifat Gjyqësore

Tarifat gjyqësore në vijim për procedurat ankimore aplikohen (shih ASC-09-0072 et.al.):

Tarifa Gjyqësore Neni 10.11 (parashtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifa Gjyqësore Neni 10.15 në lidhje me 10.21 (Aktvendimi në shkallën e dytë)	30 Euro
Totali:	60 Euro

Këto tarifa gjyqësore duhet të barten nga Ankuesi, i cili është i obliguar që të paguaj shumën e sipërpërmendur pranë Dhomës së Posaçme.

Richard Winkelhofer, EULEX Gjyqtari Kryesues	nënshkrimi
Torsten Koschinka, EULEX Gjyqtar	nënshkrimi
Eija-Liisa Helin, EULEX Gjyqtare	nënshkrimi
Tobias Lapke, EULEX Kryeregjistrues	nënshkrimi